

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Jo në emrin tim!
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/17/jo-ne-emrin-tim/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:18:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 13:16:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 13:15:00 UTC → 17 shtator 2026, 13:17:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5d91b0ee44460211170d20c477a00a26df81bc16b559baea1c6fc4d8b8702994
TEKSTI	49cc71b9655eec2d61d604f07537f5b733aa0a565966c64fd071c655a3a66c9d
PAMJA	41d188b7de394b2ecca4a8b5ee83d662e1f0bbe82d4d5ade76fb3769c3a98577

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ee6041ad555018fcf5191f607da4ca309b5d1710e52b39be099624918b4a1312
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ee6041ad555018fcf5191f607da4ca309b5d1710e52b39be099624918b4a1312>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

OPINION | TË FUNDIT

Jo në emrin tim!

17/09/2026 15:16



Nga Aladin Stafa

Në ndërkohë që koha kalon, brezat ndërrohen dhe e kaluara sa vjen dhe bëhet më e largët, ka ende momente kur historia nuk duket si diçka që e kemi lënë pas. Ajo kthehet me emra, fotografi, flamuj, kujtime e madje, dhe me një vendim gjykate. E pikërisht dje në Hagë, historia na foli sërish. Kosova u gjend edhe një herë në bankën e të akuzuarve.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi u shpallën fajtorë për disa krime lufte dhe u dënuan përkatësisht me 25, 18, 13 dhe 25 vite burg. Gjykata i gjeti përgjegjës për ndalimin arbitrar, trajtimin mizor, torturë dhe vrasje në raste të veçuara, ndërsa nga ana tjetër i shpalli të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit për mungesë provash të qenësishme. Këtu nis dhe kontradikta e kësaj gjykate speciale, duke qenë se të gjitha këto akuzat ndërlidhen me njëra-tjetrën brenda këtij konteksti.

Si është e mundur të shpallesh të pafajshëm për krime kundër njerëzimit, por ndërkaq të dënohesh për vrasje e torturë?

Nëse faktet apo provat nuk mjaftojnë, nuk është e mundur që vendimet të merren nëpërmjet perceptimit, hamendësisë apo dhe lobimit. E aq më tepër të gjykohej në mënyrë kaq indirekte historia e një populli.

Sepse pas këtij vendimi qëndron një luftë, një brez, qindra-mijëra familje që kanë humbur njerëzit e tyre të dashur e të tjerë që ranë dëshmorë në betejat të përgjakshme. Qëndron vetë Kosova. E asesi nuk mund të jetë një kapitull i mbyllur në një libër, por pjesë e identitetit të saj.

Drejtesia ushqehet me prova. Historia ka nevojë për kontekst, ndërsa kujtesa lyp identitet.

Dhe nëse ky trinom ngec diku, atëherë padrejtësia zë vend.

Historia e Kosovës nuk nisi dje në Hagë e as nuk mbaron aty. Ajo mbart mbi vete historinë shumëvjeçare të një populli që jetoi nën represionin torturues të regjimit të Beogradit, vijoi me rezistencën e përgjatë viteve '90, e më pas mori udhë me përshkallëzimin e konfliktit deri në krijimin e UÇK-së. Ndërhyrja e NATO-s ishte ndërmarrja e fundit që i dha një definicion politikohistorik mbarë luftës, derisa u kulmua me çlirimin e një Kosove që do të merrte rrugën drejt shtetësisë.

Në këtë rrugëtim, UÇK-ja ishte rezistenca fizikisht më kryesore ndaj agresorit, andaj vendimi i Hagës shkollon përtej katër individëve, duke cenuar ndjeshëm vetë historinë. Një histori jo aq triumfuese e një populli, por e denjë për të kërkuar të mos zhdukej nga ku kishte lindur.

E këtu na lind pyetja që duket se është më e madhe se një aktgjykim.

Cfarë ndodh kur drejtësia dhe kujtesa e një kombi përplasen?

I Kryesore



LIVE/ Deputetët në seancë plenare. Përshkallëzon tubimi jashtë Kuvendit, protestuesit godasin me vezë dhe bllokojnë rrugën. Shoqërohet Dritan Goxhaj dhe disa të tjerë

12:30

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente të falsifikuar/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe përfituesi

10:23

Kuvendi nis me dënimin e Hagës për liderët e UÇK-së, Peleshi: Një vendim i dhimbshëm jo vetëm për Kosovën, por edhe për historinë tonë

10:41

Zgjedhjet në Rusi pa surpriza të mëdha, por Kremlin kërkon një sinjal të fortë për Putinin

09:32

Brajan Gruda merr zyrtarisht ftesën nga Gjermania e Klopp, por nuk do të luajë menjëherë

11:10

I Më të lexuarat

E rëndë në Tiranë/ 12-vjeçarja abuzohet seksualisht nga tezja dhe djali i hallës, në telefonin e të miturës u zbuluan video intime dhe...

"Apeli nuk do të sjellë ndryshime"/ Vendimi për liderët e UÇK-së, avokatja përlotet në 'Top Story': Edhe nëse 'Specialja' zhbëhet, nuk ka fuqi mbi dënimin e dhënë

Vuçiçit nuk i del inatit/ 'Studion' reagimet e zyrtarëve të lartë të rajonit pas vendimit në Hagë, ndalet te Begaj e Rama, 'kërcënon' Malin e Zi

Dënim i ish-krerëve të UÇK, Paskal Milo: Specialja u ngrit nën presionin e SHBA dhe BE, vendimi i sotëm është rrjedhojë e një kalkulimi gjeopolitik për të afruar Serbinë me Perëndimin

Gjykata e Hagës dënoi me 25 vite burg Hashim Thaçin, reagon djali i ish-liderit të UÇK: Ne e dimë historinë, ushtarët tanë e kanë të gdhendur në lëkurë

Inside Story/ Video ekskluzive nga momentet e tmerrit, kamioni zë poshtë kalimtarin në rrugë, shoferi largohet dhe...

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente të falsifikuar/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe përfituesi

LIVE/ Deputetët në seancë plenare.

që nëse nuk arrijmë të na jetojë një komb përplot.

Kosova është fakt, me një popullsi të përhershme, territor të përcaktuar, qeveri dhe institucione moderne të gatshme për raporte ndërkombëtare. Andaj nuk mundet asnjë aktgjykim apo gjykatë të mund të baltosë sakrificat apo të lëkundë pavarësinë e saj.

E megjithatë realiteti i djeshëm na u shfaq ndryshe, sepse ne nuk dimë se cili do të jetë hapi i radhës.

Në këtë botë dinamike, ku vlojnë interesat, drejtësia mungon. Gjithmonë e më shumë po e kuptojmë se udhëhiqemi nga raporti i forcave. Ndaj shqiptarët do të duhet të maksimalizojnë që këtë e tutje rëndësinë e tyre. Dhe kjo bëhet nëpërmjet një qëndrimi të tyre "unison".

Përtej folklorizmeve apo dëshirës për bashkim kombëtar, është pikërisht politika që duhet të bëjë politikën.

Nëpërmjet diplomacisë, investimeve në mbrojtje, rritjes në ekonomi dhe ndërtimit të një shoqërie të stabilizuar, shteti rrit prestigjin e tij për t'u bërë faktor në tryezat ndërkombëtare e jo vetëm si pjesëmarrës.

E ndoshta nga kjo ditë negative për ne si ajo e djeshmja, mund të nxjerrim diçka pozitive. Një mesazh që peshon më shumë se fjalët e z. Smith. Që bashkimi e uniteti të na bëjnë më të fortë.

Sëmundja jonë e madhe është kujtesa, e ndoshta kjo është lufta që duhet të fitojmë tani.

Jo kundër njëri-tjetrit, por kundër harresës. Prandaj sot, duhet të mendojmë për një komb, i cili ende nuk ka mësuar si të jetojë me paqen pas një lufte.

Lufta është e thjeshtë, sepse armiku që ke përballë shihet qartë. Por në paqe shpesh ai nuk ka uniformë, sepse vjen nëpërmjet ndarjes politike, algoritmit në rrjete sociale apo manipulimit ndaj shoqërisë për përçarje.

Asnjë parti, gjykatë apo qeveri nuk është një komb. Sepse kombi mbetet kur të gjitha këto largohen. E ndoshta pyetja më e rëndësishme pas shumë vitesh nuk do të jetë kush fitoi dje në Hagë, por se si shqiptarët luftuan për të ruajtur historinë e tyre pa e kthyer atë në urrejtje.

Sepse mund të të gjykojë historia, mund të të gjykojë drejtësia, mund të na gjykojnë të tjerët – por ne nuk duhet të gjykojmë njëri-tjetrin deri në pikën sa të harrojmë se jemi i njëjti popull, i njëjti komb.

Ndaj dhe beteja vazhdon.

Top Channel

I Opinion »




Në emër të popullit të Kosovës

17/09 14:53



Historia mund të gjykohej, por jo të rishkruhet

16/09 15:11



Ku banojnë 4.28 milionë shtetasit shqiptarë që kanë lindur në Shqipëri?

14/09 19:55



Drejtësia kërkon drejtësi... për rogen e vet!

14/09 11:35



Në Shqipërinë e sotme "revolucion" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë

13/09 20:32



Dhoma nr. 9

12/09 20:08

Pershikanezon tubimi jashtë Kuvendit, protestuesit godasin me vezë dhe bllokojnë rrugën. Shoqërohet Dritan Goxhaj dhe disa të tjerë

Publikohen fotot e dëmeve nga sulmet iraniane në bazat amerikane, avionë të dëmtuar dhe infrastrukturë e shkatërruar në Lindjen e Mesme

Alarm në Gjermani, "plas" malaria e aeroportit, 8 të prekur e dy viktima në Frankfurt

Na ndiqni:

Top Channel

@topchannelalbania

@tchbreakingnews

Top Channel

I Video »



Top Channel/ Protestë e bllokime rrugësh në Tiranë. Protestuesit përplasen me policinë



Top Channel/ Berisha denoncon Ballukun. I kujton gjyshin. Kryetari i PD: Balluku nuk e lëshon Ramën



Top Channel/ Debat për pagat në Drejtësi. PD kërkon tërheqjen e projektligjit, mazhoranca e rrëzon



Top News- Falsifikuan pronat në Seman/Fier, arrestohen 3 punonjës të ASHK dhe përfituesi i tokës



Top News – A është gati NATO për luftë??? Ukraina përshtatet shpejt, aleancës i duhen dekada



Top Channel/ Mesazhi i Krasniqit nga Haga. Familja flet për Top Channel: Nuk i ka bërë keq askujt

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Topin e kam unë – Apliko tanil!
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.